

4480
17/06/16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

GJYKATËS SË LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

DHE

MINISTRISË SË INTEGRIMIT EUROPIAN

“PËR

**HARMONIZIMIN E TË DHËNAVE STATISTIKORE DHE RAPORTIMIN E ECURISË SË
GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE PENALE QË LIDHEN ME VEPRAT PENALE TË
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”**

Ministria e Lartë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Integritetit Evropian, në vijim të quajtura Palët:

Duke marrë në konsideratë se korrupsioni dhe krimi i organizuar janë ndër pengesat kryesore në përparimin e Shqipërisë;

Duke marrë në konsideratë se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare;

Duke konfirmuar angazhimin institucional dhe interesin e përbashkët për krijimin e një sistemi të konsoliduar të të dhënave statistikore dhe gjurmimin e rasteve konkrete lidhur me veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke synuar plotësimin e këtij prioriteti dhe vlerësimin e vazhdueshëm të përparimit të arritur;

Duke synuar paraqitjen e statistikave të besueshme dhe informacionit të plotë mbi vijimësinë e ndjekjeve dhe ndëshkimeve penale për veprat penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Duke synuar paraqitjen e këtyre statistikave dhe informacioneve për institucionet publike shqiptare dhe shërbimet e Komisionit Evropian;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon detyrimet e tyre institucionale në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandum,

Neni 1 Qëllimi

Memorandumi ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit mes Palëve për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave të besueshme dhe të plota që demonstrojnë vijimësinë e ndjekjeve dhe ndëshkimeve penale për veprat penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Neni 2 Objekti i bashkëpunimit

Palët nëpërmjet këtij Memorandumi, synojnë:

- a) të mbledhin, përpunojnë dhe raportojnë të dhëna statistikore për ndjekjet dhe vendimet penale për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;
- b) të mbledhin, përpunojnë dhe raportojnë të dhëna mbi ecurinë e ndjekjeve dhe gjykimeve penale deri kur vendimi i gjykatës kompetente të marrë formë të prerë për çështjet penale që lidhen me veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

- a) shkëmbimit periodik të të dhënave statistikore dhe të informacionit mbi ecurinë e ndjekjeve dhe gjykimeve penale për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;
- b) zhvillimit të takimeve konsultative për adresimin e kërkesave, për sigurimin e përputhshmërisë së të dhënave dhe bashkërendimin e informacionit të kërkuar.

Neni 4 Detyrimet e Palëve

1. Gjykata e Lartë është përgjegjëse për:

- a) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e informacionit statistikor mbi numrin e çështjeve penale të gjykuara, numrin e personave të gjykuar, numrin e personave të shpallur të pafajshëm dhe numrin e personave të shpallur fajtorë, në vendimet e formës së prerë të dhëna nga kjo Gjykatë gjatë periudhës së raportimit;
- b) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi çështje e veçanta gjyqësore të korrupsionit dhe krimin të organizuar të cilat janë në proces apo janë gjykuar nga kjo Gjykatë. Ky informacion përfshin numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në këtë gjykatë, numrin dhe datën e vendimit për këtë çështje (nëse Gjykata e Lartë ka dhënë vendim në lidhje me çështjen) dhe të dhëna mbi dispozitivin e vendimit gjyqësor të çështjes (ecuria e mëtejshme e çështjes), si dhe të dhëna të tjera të nevojshme sipas kërkesave;
- c) raportimin e informacionit të kërkuar sipas pikës a) dhe b) pranë Ministrisë së Drejtësisë, për gjashtëmujorin e parë të vitit brenda datës 10 ose ditës së parë të punës pas kësaj date, të muajit korrik

... në vazhdim dhe për gjashtëmujorin e dytë të vitit brenda datës 10 ose ditës së parë të punës pas kësaj date, të muajit janar të vitit pasardhës.

2) Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për:

- a) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e informacionit statistikor mbi numrin e personave të gjykuar, numrin e personave të shpallur të pafajshëm dhe numrin e personave të shpallur fajtorë, sipas vendimeve të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit;
- b) mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi çështje gjyqësore të cilat janë në proces apo janë gjykuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Ky informacion përfshin numrin dhe datën e regjistrimit të çështjes në këto gjykata, numrin dhe datën e vendimit gjyqësor për çështjen (nëse gjykata ka dhënë vendim në lidhje me çështjen) dhe të dhëna mbi dispozitivin (ecuria e mëtejshme e çështjes), si dhe të dhëna të tjera të nevojshme sipas kërkesave;
- c) konsolidimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore të raportuara nga gjykatat e shkallës së parë, të apelit dhe nga Gjykata e Lartë dhe përfshirjen e tyre në tabelat e integruara;
- d) raportimin e të dhënave dhe informacionit të integruar për gjashtëmujorin e parë të vitit brenda datës 31 ose ditës së parë të punës pas kësaj date, të muajit korrik të vitit në vazhdim dhe për gjashtëmujorin e dytë të vitit brenda datës 31 ose ditës së parë të punës pas kësaj date, të muajit janar të vitit pasardhës.

3) Ministria e Integritetit Europian është përgjegjëse për:

- a) përcjelljen e shpejtë dhe dhënien e informacionit të nevojshëm sqarues mbi kërkesat e shërbimeve të Komisionit Europian;
- b) koordinimin e procesit ndërmjet institucioneve me qëllim realizimin e shpejtë të raportimit të kërkuar;
- c) dhënien e asistencës dhe mbështetjes së nevojshme për përgatitjen dhe raportimin në kohë dhe me cilësi të informacionit të kërkuar.

Neni 5

Gjuha e informacionit të mbledhur dhe përpunuar

Palët paraqesin informacionin e kërkuar në gjuhën angleze.

Neni 6

Periodhat e raportimit

Të dhënat statistikore do të mblidhen, përpunohen dhe raportohen për periudha gjashtëmujore.

Periodha e parë gjashtëmujore për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave mbi ecurinë e ndjekjeve dhe gjyqimeve penale do të jetë janar – qershor 2016.

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave personale

rtimi i të dhënave statistikore dhe informacionit specifik mbi çështjet gjyqësore do të kryhet në puthje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin shqiptar për statistikën.

Neni 8

Afatet përjashtimore të shkëmbimit të informacionit

1. Përjashtimisht, bazuar në kërkesën e shërbimeve të Komisionit Evropian, në kuadër të takimeve të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ose negociatave të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, palët mbledhin, përpunojnë dhe shkëmbejnë të dhënat statistikore dhe informacionin e kërkuar edhe për periudha të tjera kohore të ndryshme nga ajo e parashikuar në nenin 6, të këtij Memorandumi.
2. Afati kohor për raportimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar nga Gjykata Lartë nuk do të jetë më i shkurtër se 10 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës për informacion nga Ministria e Drejtësisë dhe/ose nga Ministria e Integrimit Evropian. Afati kohor për raportimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë nuk do të jetë më i shkurtër se 15 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës për informacion nga Ministria e Integrimit Evropian.

Neni 9

Vlerësimi i zbatimit të Memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të Memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së raporteve periodike me shkrim pranë titullarëve të të Palëve.
2. Raporti periodik përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të Memorandumit, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 10

Komunikimi mes Palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ ose në rrugë elektronike.
2. Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e kërkesave të tyre në zbatim të Memorandumit.
3. Palët do të informojmë njëri-tjetrin mbi personat e kontaktit jo më vonë se 15 ditë nga nënshkrimi i këtij Memorandumi.
4. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 11
Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 12
Ndryshimi i Memorandumit

Ky Memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 13
Përfundimi i Memorandumit

1. Memorandumi lidhet pa afat, por mund të përfundojë në çdo kohë me marrëveshje mes Palëve. Përfundimi hyn në fuqi një muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim nga njëra prej Palëve.

2. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, Palët iu përmbahen kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 15
Hyrja në Fuqi

1. Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të Palëve.

2. Ministria e Integrimit European informon shërbimet e Komisionit Evropian mbi nënshkrimin e këtij Memorandumi.


3. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje origjinale, 2 (dy) kopje depozitohen në Ministrinë Drejtësisë, 2 (dy) kopje depozitohen në Gjykatën e Lartë dhe 2 (dy) kopje të tjera depozitohen në Ministrinë e Integrimit European.

Ky Memorandum nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 17 / 06 /2016.

PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË

MINISTRI

YLLI MANJANI



Ylli Manjani

PËR
GJYKATËN E LARTË

KRYETARI

XHEZAIR ZAGANJORI




Xhezaïr Zaganjori

PËR
MINISTRINË E INTEGRIMIT EUROPIAN

MINISTRI

KLAJDA GJOSHA



Klajda Gjoshë